

Procedura e zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara përcaktohen në Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht:

Neni 23

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i ADISA-s, i cili emërohet nga ministri përgjegjës.
2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Drejtues.
3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit, pa të drejtë vote.

Neni 24

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së ADISA-s;
- b) paraqet për miratim në Këshillin Drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të ADISAs;
- c) i propozon, sipas legjislacionit në fuqi, Këshillit Drejtues strukturën organizative të ADISA-s dhe nivelin e pagave për punonjësit;
- ç) paraqet për miratim në Këshillin Drejtues buxhetin dhe programin përkatës të punës përpara fillimit të çdo veprimtarie;
- d) harton dhe paraqet për miratim në Këshillin Drejtues programin ekonomik-financiar të ADISA-s, si dhe masën e tarifave që do të zbatohen për të gjitha shërbimet që ofron ky institucion;
- dh) ushtron kompetencat në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- e) përcakton dhe paraqet për miratim në Këshillin Drejtues kërkesat për çdo pozicion pune, kriteret e punësimit të personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përparësitë e ADISA-s dhe me rregulloren e tij të brendshme;
- ë) emëron personelin e nevojshëm, sipas kriteve të përcaktuara, si dhe administron burimet njerëzore e kualifikimet tyre;
- f) përfaqëson ADISA-n në marrëdhëniet me të tretët;
- g) ushtron të gjitha detyrat e ADISA-s, në zbatim të legjislacionit në fuqi.